
DISKUTIME

ADRIAN HAXHILLAZI**E KRYERA E MBIPËRBËRË E GJUHËS SHQIPE******1. Formimi i së kryerës së mbipërbërë të shqipes dhe kuptimi i saj gramatikor kohor***

Krahas formës gramatikore të së shkuarës, që është quajtur “e kryer”, ose që ne e kemi saktësuar “e kryer e përbërë”, gjuha shqipe ka dhe një formë tjetër të veçantë foljore të së shkuarës, që është emërtuar “**formë e mbipërbërë e së shkuarës**” dhe “**e kryer e dytë**”¹. Këtë formë gramatikore kohore po e japim me emërtimin “**e kryera e mbipërbërë**” për ta njësuar e dalluar formalisht nga e kryera e thjeshtë dhe e kryera e përbërë.

Kësaj forme foljore nuk i është dhënë vendi i plotë në ndarjen e formave gramatikore të kohës së shkuar. Duke e përmendur në një “shënim” të veçantë, kjo formë gramatikore është shoqëruar vetëm me shpjegimin për ndërtimin strukturor (formal) të saj. Këtë formë foljore të kohës së shkuar kemi parapëlqyer ta quajmë “**e kryer e mbipërbërë**”, sepse është formë gramatikore e veçantë, e cila vjen sipas rendit të vet pas së kryerës së thjeshtë, që ka formë sintetike dhe menjëherë pas së kryerës së përbërë, e cila ka formë analitike me dy përbërës dhe që për ta saktësuar e kemi emërtuar “**e kryer e përbërë**”.

Forma gramatikore e së kryerës së mbipërbërë të gjuhës shqipe ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format e së kryerës së përbërë së foljes ndihmëse. Për ta plotësuar ndërtimin e kësaj forme foljore duhet shtuar se për formën veprorë të foljeve pjesores i shtohen format e së kryerës së përbërë të foljes ndihmëse “**kam**” (përkatësisht *kam pasë, ke pasë, ka pasë, kemi pasë, keni pasë, kanë pasë*). Te format e së kryerës së përbërë të foljes ndihmëse “**kam**” kemi një pjesore “**pasë**” dhe jo një pjesore me mbaresën **-ur** “**pasur**”. Pra gjuhës standarde shqipe i duhet njohur jo

* Pjesë e shkëputur si artikull nga doktorata: “Format gramatikore të kohës së shkuar të mënyrës dëftore të foljeve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane – Vështrim krahasues midis të dyja gjuhëve”.

¹ Shih: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 289.

vetëm përdorimi i një pjesoreje me **-ur**, por edhe i një pjesoreje pa mbaresën formale **-ur** të toskërishtes a **-un** të gegërishtes, e cila ka si mbaresë **-ë**.

Për formën e diatezave joveprore (pësore dhe vetvetore) të foljeve, pjesores i shtohen format e së kryerës së përbërë të foljes ndihmëse “*jam*” (përkatësisht *kam qenë, ke qenë, ka qenë, kemi qenë, keni qenë, kanë qenë*).

Paradigma e plotë e së kryerës së mbipërbërë të gjuhës shqipe është:

	Forma veprore	Forma pësore-vetvetore
Unë	kam pasë larë	kam qenë larë
Ti	ke pasë larë	ke qenë larë
Ai/Ajo	ka pasë larë	ka qenë larë
Ne	kemi pasë larë	kemi qenë larë
Ju	keni pasë larë	keni qenë larë
Ata/Ato	kanë pasë larë	kanë qenë larë

Kjo formë gramatikore e së kryerës së mbipërbërë të mënyrës dëftore të foljeve përdoret si në ligjërimin e folur, ashtu edhe në ligjërimin e shkruar të shqipes, pra ajo nuk ka kufizim ligjërimor në gjuhën shqipe.

Me qenë se forma gramatikore e së kryerës së përbërë është formë foljore analitike, pra është formë gramatikore e përbërë nga dy elemente (p.sh.: *kam larë*), “*forma e dytë e së kryerës*” është quajtur “*e kryer e mbipërbërë*”, sepse nuk përbëhet nga dy elemente, por nga tri elemente përbërëse të formës gramatikore. Pra nga ana ndërtimore është më shumë analitike se forma gramatikore e së kryerës së përbërë (p.sh.: *kam pasë larë*).

Është e nevojshme që për këtë formë gramatikore të shqyrtohet jo vetëm ana e saj formale, që është qartësisht e dukshme, por edhe kuptimi i kësaj forme gramatikore të kohës së shkruar.


Gramatika e gjuhës shqipe këtë formë foljore të së shkruarës e ka përcaktuar si një të kryer të dytë, e cila ka kuptim të ngjashëm me të kryerën e përbërë: “Për sa i takon së kryerës së dytë, kjo ka një kuptim të ngjashëm

me atë të së kryerës, veçse përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët².

Kuptimi i formës foljore “*e kryera e mbipërbërë*” në *Gramatikën e gjuhës shqipe* është vështruar si “*kuptim i ngjashëm me atë të së kryerës*”, porse i dallueshëm prej saj sepse kjo formë “përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët”, pra dallimi me të kryerën e përbërë shihet në kuptimin e saj gramatikor kohor “për veprime të një të shkuare të largët”.

Në të vërtetë forma gramatikore e së kryerës së përbërë dallohet qartë nga forma foljore e “*së kryerës së dytë*” a e “*së kryerës së mbipërbërë*”. Ky dallim nuk është vetëm në anën formale të paraqitjes me elemente përbërëse (me dy apo me tri përbërës formale), por edhe në rrafshin e kuptimit gramatikor kohor të këtyre formave foljore të së shkuarës. Është e rëndësishme të vihet në dukje se në përcaktimin “veprime të një të shkuare të largët” kemi dallim në kuptimin e saj gramatikor kohor si formë e veçantë gramatikore e së shkuarës. Kur themi “*e shkuar e largët*” i është vënë një përcaktor (*i largët*) veprimit të foljes që ka ndodhur a është kryer në kohën e shkuar. Pra, kemi shënuar se veprimi i foljes në këtë formë gramatikore të së shkuarës është relativisht i përcaktuar. Ai është vendosur a është lokalizuar në njërën pjesë (dhe kjo është pjesa e largët dhe jo pjesa e afërt) të shtrirjes a të zgjatjes kohore të veprimit në kohën e shkuar.

Është e nevojshme këtu që të sqarojmë më mirë se çfarë lidhjeje kanë format gramatikore të së shkuarës me shtrirjen kohore të veprimit të foljes në kohën e shkuar. Për ta rrokur më mirë zgjatjen kohore të veprimit në kohën e shkuar të foljes po japim diagramin e mëposhtëm për të tria kohët gramatikore:



Koha e shkuar, ashtu si edhe koha e ardhme në këtë diagram, jepet si kohë që ka zgjatjen e vet kohore nga *pika A*, që merret si pikënisja më e largët kohore (kjo pikë mbetet gjithnjë e papërcaktuar) e deri pranë *pikës B*,

² Shih: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 314.

e cila shënon kohën e tashme dhe çastin a momentin e ligjërimit të folësit a të shkruesit për format gramatikore kohore të së shkuarës: e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera e përbërë. Kur veprimi i foljes përputhet me çastin e ligjërimit, atëherë kemi kohën e tashme të foljes. Pra, koha e tashme nuk ka shtrirje a zgjatje kohore, ashtu siç e kanë këtë zgjatje kohore të dyja kohët e tjera gramatikore të foljes, koha e shkuar dhe koha e ardhme. Prandaj koha e tashme jepet në trajtë pike (*pika B*), sepse kjo kohë nuk e ka përmasën e një veprimi të zgjatur në kohë, siç e kanë koha e shkuar dhe koha e ardhme.

Zgjatja kohore e veprimit a e gjendjes që shënon folja nis a zë fill në një çast a moment të largët kohor që është gjithmonë i papërcaktuar dhe nuk i dihet fillimi (*pika A*). Shtrirja a zgjatja kohore ka vijimësinë a rrjedhën e vet pas çastit kohor të papërcaktuar, që në grafikun e mësipërm e kemi dhënë në trajtën lineare të një vije të drejtë që shkon nga pika më e largët dhe e papërcaktuar e së shkuarës e deri pranë pikës së kohës së tashme, që përputhet me çastin e ligjërimit (*pika B*).

Koha e shkuar si kohë gramatikore shënon veprime a gjendje të foljeve që janë kryer a kanë ndodhur përpara kohës së tashme dhe përpara çastit të ligjërimit të folësit apo të shkruesit, kur ai e ka zhvendosur veprimin foljor në kohën e shkuar. Shtrirja a zgjatja kohore e së shkuarës e ka nisjen a fillimin të papërcaktuar (*pika A*) dhe mbarimin e saj deri pranë çastit të ligjërimit (*pika B*), e cila shënon edhe kohën e tashme të foljes. Ky kufizim i shtrirjes kohore të veprimit a të gjendjes së foljes ka gjithnjë vlera relative përcaktimi dhe asnjëherë nuk arrin në vlera absolute.

Format gramatikore të kohës së shkuar e shënojnë veprimin e foljes gjithnjë ose duke e vendosur a duke e lokalizuar veprimin në zgjatjen a shtrirjen kohore në të kaluarën dhe në këtë rast veprimi a gjendja jepet si *veprim i përcaktuar* në kohë, si veprim i lokalizuar a i vendosur në një çast të kësaj shtrirjeje kohore të së shkuarës, ose duke mos e vendosur në një çast të dhënë të kësaj zgjatjeje a shtrirjeje kohore të së shkuarës dhe në këtë rast veprimi a gjendja jepet si *veprim i papërcaktuar* në shtrirjen kohore, si veprim i palokalizuar a i pavendosur në një çast të kësaj shtrirjeje a zgjatjeje kohore të së shkuarës.

Format gramatikore që e shënojnë veprimin e foljes si veprim të përcaktuar në kohë, pra si veprim të lokalizuar a të vendosur në një çast të shtrirjes kohore të së shkuarës, janë modifikuar duke e ndryshuar kuptimin kohor të së shkuarës dhe duke u specializuar edhe më tej kuptimisht. Ky specializim kuptimor ka sjellë edhe ndarje të mëtejshme kohore të këtyre formave gramatikore të kohës së shkuar në gjuhën shqipe.

Forma gramatikore kohore e së kryerës së thjeshtë shënon një veprim të afërm në krahasim me çastin e ligjëritimit në kohën e tashme, pra kjo formë e vendos, e lokalizon veprimin e foljes me pjesën më të afërme të zgjatjes kohore të së shkuarës, që ndodhet pranë kohës së tashme të foljes.

Forma gramatikore kohore e së kryerës së mbipërbërë shënon një veprim më të largët në krahasim me çastin e ligjëritimit në kohën e tashme, pra kjo formë e vendos, e lokalizon veprimin e foljes me pjesën më të largët të shtrirjes kohore të së shkuarës që përcaktohet në krahasim me çastin e ligjëritimit.

Kemi dhe një formë tjetër gramatikore të kohës së shkuar, dhe kjo është e kryera e përbërë, e cila e shënon veprimin e foljes si veprim që nuk përcaktohet në zgjatjen e vet kohore, pra ajo e jep veprimin foljor të palokalizuar a të pavendosur në shtrirjen kohore të kohës së shkuar.

Nga sistemi i formave gramatikore të së shkuarës në gjuhën shqipe morëm dhe analizuam bashkërisht dhe në lidhje me njëra-tjetrën tri forma (e kryera e thjeshtë, e kryera e përbërë dhe e kryera e mbipërbërë), sepse si forma gramatikore kohore të së shkuarës ato përbëjnë një bllok a grup më vete që kanë kuptime të përbashkëta dhe kuptime të dallueshme midis tyre:

1 – Që të tria format gramatikore kanë të përbashkët se shënojnë kuptimin e veprimit të kohës së shkuar, pra shënojnë një veprim që ka ndodhur a është kryer përpara çastit të ligjëritimit. Dy nga këto forma gramatikore kohore (e kryera e thjeshtë dhe e kryera e përbërë) i referohen një veprimi a gjendjeje që krahasohet me çastin e ligjëritimit në kohën e tashme të foljes, kurse e kryera e mbipërbërë i referohet një veprimi a një gjendjeje që krahasohet me çastin e ligjëritimit në të kryerën e përbërë të kohës së shkuar.

2 – Që të tria format gramatikore kanë të përbashkët se shënojnë kuptimin e veprimit në aspektin e kryer, pra shënojnë një veprim që ka nisur, ka vijuar dhe ka përfunduar, ndryshe nga e pakryera që shënon një veprim që ka nisur, që vijon por që nuk ka të përfunduar, pra shënon një veprim që nuk ka mbaruar ende.

3 – Që të tria format gramatikore kanë të dallueshme midis tyre shprehjen e lidhjes ose të moslidhjes së veprimit të foljes me një çast të dhënë të shtrirjes a të zgjatjes kohore të së shkuarës.

E kryera e thjeshtë (p.sh.: *lava*) shënon një veprim të papërcaktuar që nuk është vendosur a nuk është lokalizuar në një çast të dhënë të pjesës së afërme të shtrirjes kohore të së shkuarës.

E kryera e përbërë (p.sh.: *kam larë*) shënon një veprim të papërcaktuar, pra shënon një veprim që nuk është vendosur a nuk është lokalizuar në një çast të dhënë të zgjatjes kohore të së shkuarës.

E kryera e mbipërbërë (p.sh.: *kam pasë larë*) shënon një veprim të papërcaktuar që nuk është vendosur a nuk është lokalizuar në një çast të dhënë të pjesës së largët të shtrirjes kohore të së shkuarës.

Specializimi kuptimor i këtyre formave gramatikore të së shkuarës ka bërë që dy format gramatikore të saj (e kryera e thjeshtë dhe e kryera e mbipërbërë) ta ndajnë segmentin e shtrirjes apo të zgjatjes kohore të së shkuarës në dy pjesë: njëra pjesë është pranë çastit të ligjëritimit (me këtë lidhet veprimi i së kryerës së thjeshtë) dhe pjesa tjetër është larg çastit të ligjëritimit (me këtë lidhet veprimi i së kryerës së mbipërbërë). Pjesa $A_1 - B$ e segmentit të zgjatjes a të shtrirjes kohore të së shkuarës është pranë çastit të ligjëritimit. Në këtë shtrirje kohore veprimi i foljes është i afërm me çastin e ligjëritimit. Pjesa $A - A_1$ e segmentit të zgjatjes a të shtrirjes kohore të së shkuarës është larg çastit të ligjëritimit. Në këtë shtrirje kohore veprimi i foljes është i largët në krahasim me çastin e ligjëritimit (shih diagramin e mësipërm për shtrirjen a zgjatjen kohore të së shkuarës dhe të së ardhmes).

Nga shqyrtimi i mësipërm i kuptimeve kohore të përbashkëta dhe të dallueshme të tri formave gramatikore të së shkuarës del se folja shënon një *veprim të përcaktuar* kur kuptimisht ajo është vendosur në një çast të dhënë të shtrirjes a të zgjatjes kohore të së shkuarës (me njërin prej dy pjesëve të kësaj shtrirjeje kohore, me pjesën e afërme a me pjesën e largët në krahasim me çastin e ligjëritimit). Lidhjen e kuptimit me pjesën e afërme të shtrirjes kohore të së shkuarës e bën forma gramatikore e së kryerës së thjeshtë, kurse lidhjen e kuptimit me pjesën e largët të shtrirjes kohore të së shkuarës e bën forma gramatikore e së kryerës së mbipërbërë.

Nga ana tjetër folja shënon, pra edhe mund të shënojë, një *veprim të papërcaktuar* kur kuptimisht ajo nuk vendoset në një çast të dhënë të shtrirjes a të zgjatjes kohore të së shkuarës. Një veprim të tillë të papërcaktuar e shënon forma gramatikore e së kryerës së përbërë. Më sipër parapëlqyem që veprimin foljor ta emërtojmë si *veprim të përcaktuar* ose si *veprim të papërcaktuar*, por për “*veprime të caktuara*” dhe për “*veprime të pacaktuara*” është shkruar në *Gramatikën e gjuhës shqipe*³ dhe për këtë ndarje binare (dyshe) të veprimit të foljes nuk është dhënë ndonjë shpjegim i posaçëm dhe i nevojshëm. Ndarja binare “*veprim i përcaktuar*” dhe “*veprim i papërcaktuar*” mendojmë se ka lidhje dhe ndikon në kuptimin gramatikor të formave foljore të së shkuarës, të cilat e shënojnë veprimin e foljes në

³ Shih: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 306, f. 309.

kohën e shkuar herë të lokalizuar a të vendosur në një çast të dhënë të shtrirjes kohore të së shkuarës dhe në këtë rast kemi “*veprim të përcaktuar*” dhe herë të palokalizuara a të pavendosur në një çast të dhënë të shtrirjes kohore të së shkuarës dhe në këtë rast kemi “*veprim të papërcaktuar*”. Këto dallime semantike të veprimit foljor ndikojnë në semantikën foljore të formave gramatikore kohore të së shkuarës.

Veprim të përcaktuar shënojnë format gramatikore të së kryerës së thjeshtë dhe të së kryerës së mbipërbërë, kurse *veprim të papërcaktuar* shënon forma gramatikore e së kryerës së përbërë. E kryera e thjeshtë e shënon shtrirjen kohore të veprimit foljor në pjesën e afërme të zgjatjes kohore të së shkuarës dhe e kryera e mbipërbërë e shënon shtrirjen kohore të veprimit foljor në pjesën e largët të zgjatjes kohore të së shkuarës së foljes. Në të dyja këto forma gramatikore folja shënon *veprim të përcaktuar*. Për shprehjen e një *veprimi të përcaktuar* apo të një *veprimi të papërcaktuar* do të flitet edhe për format e tjera gramatikore të kohës së shkuar.

Dallimi i *veprimeve të përcaktuara* nga *veprimet e papërcaktuara* ka rëndësi në semantikën foljore të formave gramatikore kohore të së shkuarës. Nga prania e këtyre dallimeve janë veçuar dhe funksionojnë si forma gramatikore më vete edhe nënndarjet kohore të së shkuarës së mënyrës dëftore të gjuhës shqipe.

Format gramatikore të kohës së shkuar të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe përbëjnë një sistem më të plotë formash gramatikore që pasqyrojnë dallimet kohore të së shkuarës. Gjuha shqipe ka forma gramatikore të kohës së shkuar që bëjnë dallime të mëtejshme kuptimore kohore.

Le të japim një shembull për përdorimin e së kryerës së mbipërbërë në gjuhën shqipe:

- “O moj Shqipni, e mjera Shqipni,
Kush të ka qitun me krye në hi,
Ti ke pasë qenë një zonjë e randë,
Burrat e dheut të thirrshin nanë.”⁴

Edhe në publicistikën e sotme e kryera e mbipërbërë përdoret në shkrime të ndryshme:

- Në të shkuarën e afërt e të largët, të gjithë krerët ballkanikë, tek e fundit, në mos *kanë pasë qenë*, herët a vonë, pas dehjes me vetveten, prej nepsit për pushtet të pakufizuar, në epilog të pushtetërimit të tejzgjatur, janë

⁴ Këto vargje janë shkëputur nga vjersha shumë e njohur “O moj Shqipni!” e Pashko Vasës.

katandisur në udhëheqës të dalldisur, të një dalldie që nis vetjakisht e përfundon në marrosje ekipore... (*Gazeta Shqiptare*, 10. 02. 2011, f. 29)

- Në mjediset ballkanike, tradicionalisht, dalldia politike *ka pasë luajtur* rol parësor në lëvizjet kombëtare, në përmbysjet sociale, në marrëdhëniet ndërnjerezore e sidomos në ato shtetërore. (*Gazeta Shqiptare*, 10. 02. 2011, f. 29)

Me këto shembuj të mësipërm dëshmohet se forma gramatikore kohore e më se të kryerës së mbipërbërë të kohës së shkuarës të foljes ka zënë vend të qëndrueshëm në standardin e gjuhës shqipe.

2. E kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe

në sistemin e formave gramatikore foljore të kohës së shkuar

E kryera e mbipërbërë e shqipes është formë gramatikore kohore *analitike* me 2 (*dy*) gjymtyrë kryesore të kësaj forme (*folja ndihmëse në të kryerën e përbërë + pjesorja e shkuar e foljes kryesore*), të cilat ngërthejnë 3 (*tre*) *elemente* gjuhësore dhe për këtë shprehje formale të këtyre elementeve është më e drejtë që të shënohet si *e kryer e mbipërbërë*.

Kjo formë e veçantë gramatikore kohore dhe analitike në sistemin e formave foljore të kohës së shkuar të mënyrës dëftore të gjuhës shqipe është formuar nga *dy* gjymtyrë kryesore. Gjymtyra e parë është folja ndihmëse në kohën e shkuar dhe në formën gramatikore të së kryerës së përbërë. Gjymtyrës së parë i shtohet si gjymtyrë e dytë pjesorja e shkuar e foljes kryesore dhe kështu me këtë ndërtim analitik dygjymtyrësh është formësuar e kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe, e cila është formë e veçantë dhe e dallueshme gramatikore kohore e së shkuarës.

Zakonisht renditja e gjymtyrëve kryesore të së kryerës së mbipërbërë është *e përcaktuar* dhe *e ngulitur* (*folje ndihmëse në formën gramatikore të së kryerës së përbërë + pjesore e shkuar e foljes kryesore*). Forma gramatikore kohore e së kryerës së mbipërbërë përdoret edhe me renditje *të përkundërt* të gjymtyrëve të saj kryesore (*pjesore e shkuar e foljes kryesore + foljen ndihmëse në formën gramatikore të së kryerës së përbërë*) dhe midis gjymtyrëve kryesore mund të ndërkalen (ndërfuten) edhe fjalë të tjera si pjesëza ose trajta të shkurtra të përemrit vetor. Si tipar dallues i foljes ndihmëse “*kam*” është se kjo folje në të kryerën e përbërë të saj nuk ruan formën e pjesores “*pasur / pasun*” të gegërishtes, por formën “*pasë*” dhe me këtë trajtë ajo është përhapur dhe pranuar edhe në shqipen standarde.

E kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe e shënon veprimin foljor në *aspektin e kryer* dhe si veprim i cili është kryer a ka ndodhur në të shkuarën, ashtu si edhe e kryera e përbërë. Veprimi foljor i së kryerës së mbipërbërë

jepet si një veprim a gjendje që ka nisur në të shkuarën, që është kryer a ka ndodhur në zgjatjen kohore të kohës së shkuar dhe ka përfunduar a ka mbaruar si proces. Ky veprim i foljes nga pikëpamja kohore e së shkuarës përcaktohet në lidhje me të kryerën e përbërë, e cila shënohet prej foljes ndihmëse dhe që është edhe çast ligjërimit për të kryerën e mbipërbërë dhe *nuk ka lidhje kohore me kohën e tashme*, siç e ka e kryera e përbërë.

E kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe e shënon veprimin foljor si veprim të përcaktuar kohor me pjesën a segmentin *e largët* të zgjatjes kohore të së shkuarës, që ndodhet në fillimet e boshtit kohor real dhe gramatikor të së shkuarës. Pra, veprimi foljor është kryer a ka ndodhur në një çast kohor të largët, që përcaktohet për kohën e shkuar në mënyrë të përkundërt me rrjedhën kohore reale dhe në zgjatjen kohore përpara së kryerës së përbërë që merret si pikë referimi dhe si çast ligjërimit për të kryerën e mbipërbërë.

Përcaktimi kohor i largësisë së kryerjes së veprimit foljor është tipari themelor i kuptimit kohor të së shkuarës që dallon të kryerën e mbipërbërë në krahasim me format e tjera gramatikore kohore, por kjo largësi është më e madhe se e kryera e mbipërbërë dhe më e vogël se e kryera e përbërë.

